

FJALA E DEPUTETIT AGRON DUKA

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

E nderuara zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë!

Ndoqa dhe lexova me shumë vëmendje e interes programin qeverisës për këta katër vjet. Po ndalem në atë pjesë të programit, ku ju përcaktoni objektivat dhe rrugët për arritjen e objektivave për zhvillimin e bujqësisë e të fshatit. Gjithashtu, do të them dy fjalë edhe për zhvillimin e sporteve në vendin tonë. Sot në fjalën time, në emër të Partisë Agrare Ambientaliste, do të mundohem të jap kontributin tim si specialist i fushës, në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sektori të ekonomisë. Ne e konsiderojmë veten parti që mbrojmë drejtpërdrejt interesat e sektorit të bujqësisë e të zhvillimit rural, duke qenë se kemi pasur mundësi të marrim opinione dhe ekspertizën më të mirë të fushës. Gjithashtu, kemi diskutuar dhe kemi marrë propozime edhe nga grupet e interesit që operojnë në sektorin e bujqësisë. Është e vërtetë ajo që thuhet në program se sot bujqësia është një prej motorëve kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit, por, pavarësisht rritjes së volumit të prodhimit në tërësi, në rajone të caktuara apo në periudha të ndryshme kohore, vihen re problematika me efekte negative, si largimi i popullsisë nga zonat rurale, kryesisht i të rinjve, krijimi i stoqeve të produkteve bujqësore si pasojë e prodhimit të paorientuar me kërkesat e tregut, falimentimi i fermerëve si pasojë e krizave të rënda të tregut, duke çuar kështu në pasoja fatale, siç është rasti i ditëve të fundit në Roskovec.

Është fakt se në asnjë nga qeveritë e kaluara, duke përfshirë edhe qeverinë në të cilën kam qenë unë vetë, bujqësia nuk është parë si sektor prioritar. Duke u nisur nga programi që prezantuat, me keqardhje mund të them se vazhdon e njëjta mendësi. E them këtë, sepse nuk ka evidentim të problemeve dhe as propozime konkrete për zgjidhjen e këtyre problemeve, por veç trumbetohen fitoret e arritura dhe përsëriten të njëjtat problematika e politika të ndjekura vitet e fundit si suksese. Në program ju thoni se vëmendja e kthyer drejt fshatit me investimet më të mëdha të kryera ndonjëherë. Lidhja me qendrat urbane, "Rilindja" dhe trashëgimia kulturore-historike, nxitja dhe rritja e agroturizmit ka bërë sot që fshati të jetë një alternativë tërheqëse për të investuar dhe për të krijuar ekonomi. Unë them se kjo gjë qëndron vetëm për disa fshatra, të cilat numërohen me gishtat e dorës, pasi për shumicën e fshatrave vazhdon braktisja dita-ditës. Në program ju thoni: do të vijojmë mbështetjen për rritjen e eksporteve, do të zhvillojmë fshatin drejt turizmit, do të rrisim mbështetjen në bujqësi, blegtori e zhvillim rural, do të japim 70 milionë euro mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët nëpërmjet naftës pa akcizë dhe skemave kombëtare të mbështetjes. Së pari, kjo shifër nuk kuptohet nëse është për çdo vit apo për të gjithë mandatin.

Po ashtu, 146 milionë euro mbështetje nëpërmjet programit IPARD 3. Unë mendoj se çdo investim për bujqësinë sjell përmirësim të gjendjes, si heqja e akcizës së karburanteve, ashtu edhe përfitimi i granteve nga programi IPARD, gjithsesi, këto skema nuk janë gjithëpërfshirëse, prandaj ngulim këmbë se duhet të ketë subvencione direkte për çdo kilogram produkt bujqësor apo kokë bagëti. Vetëm kështu mund të përfitojnë të gjithë ata që investojnë në këtë sektor, si dhe do të mund të konkurrojnë produktet e vendeve të rajonit, të cilët duke marrë subvencione direkte nga vendet e tyre, na konkurrojnë padrejtësisht që në nisje. Kur dëgjova sot Kryeministrin të thoshte se do të ketë më shumë serra, më shumë subvencione, natyrisht që më erdhi mirë, por kjo duket si një koncept relativ, sepse

varet se mbi ç' bazë bëhet krahasimi. Nëse deri tani disa fermerë kanë marrë zero subvencione dhe themi se do të marrin dhjetë herë më shumë, rezultati del përsëri zero, sepse zero herë dhjetë bëjnë zero. Më konkretisht, duhet shprehja: çdo fermer, që merret me bujqësi e blegtori, do të subvencionohet për produktet e tij. Bujqësia jep rreth 18 % deri në 20 % të prodhimit të brendshëm bruto, punëson rreth 40 % të forcës së aftë për punë, ndaj rrjedhimisht duhet të ketë një vëmendje të madhe, e cila duhet të reflektohet me ligje të mira e me mbështetje financiare reale. Por me disa nga ligjet që propozohen dhe zbatohen aktualisht, ndodh e kundërta: vihet tatimfitimi 5 % për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor. Këtu ka një kontrast që duhet zgjidhur. SHBB-të krijohen dhe funksionojnë në bazë të një ligji të veçantë dhe kanë si qëllim nxitjen e kooperimit të fermerëve, duke përfituar nga lehtësitë fiskale. Fakti se fermerët e veçuar me xhiro deri në 10 milionë lekë të reja në vit kanë zero tatim, ndërsa një SHBB, që minimalisht duhet të përbëhet nga shtatë fermerë, e ka 5 %, të çon në konkluzionin se në këtë rast politika fiskale nuk nxit kooperimin, por e pengon atë.

Meqenëse jemi tek informaliteti i sektorit të bujqësisë dhe te skemat e subvencionit, të fermerëve nëpërmjet politikave fiskale, nuk mund të rri pa vënë në dukje një shqetësim të madh të përfaqësuesve të agrobiznesit e të fermerëve, shqetësim për të cilin kjo qeveri është në dijeni. Keni dijeni, sepse ju janë dërguar shkresa; që në dhjetor të vitit 2018 sindikata e fermerëve dhe biznesi ju kanë shkruar, kanë dalë edhe në rrugë me protesta, por, çuditërisht, kjo çështje ka ngelur pa zgjidhur. Bëhet fjalë për barazim të shkallës së TVSH-së në shitje, me atë në blerje, për sektorin e tregtimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale, që blihen direkt nga prodhuesit e pajisur me NIPT fermeri, sepse aplikimi i shkallëve të ndryshme të TVSH-së, që bëhet sot, ka sjellë efekte negative. 0 % në blerje, 20 % në shitje dhe përfshirje e të ashtuquajturës normë kompensimi 6 % në këtë mekanizëm u ka dhënë operatorëve të këtij sektori një regjim taksimi të padrejtë, për pasojë duke i orientuar të furnizohen me produkte bujqësore nga importi, duke braktisur produktin vendës. Zbatimi i kësaj mase është emergjent, ngaqë skema aktuale shtrembëron frymën e ligjit për TVSH-në dhe prish mekanizmin e vjeljes së këtij tatimi, pasi me skemën aktuale tregtarët apo agropunuesit nuk paguajnë më TVSH, por de facto paguajnë 14 % tatim mbi qarkullimin, tatim i cili nuk ekziston në legjislacionin fiskal shqiptar. Nëpërmjet kësaj skeme nuk realizohet qëllimi për të cilin u vu në zbatim, për kompensim të fermerëve me 6 % të çmimit. Për këtë, ju vetë deklaruat kohë më parë, se kur u bë ndërrimi i kësaj skeme, 20-përqindëshi i kompensimit nuk ka shkuar te fermerët, ndërkohë që çuditërisht besohet se 6-përqindëshi shkon. Ne jemi të bindur se rregullimi i këtij mekanizmi që është aktualisht do të formalizonte qarkullimin e brendshëm të produkteve bujqësore, do të vinte operatorët e këtij sektori në kushtet e një taksimi të ligjshëm e të ndershëm, gjë e cila përbën detyrim kushtetues për një qeveri, për pasojë do të rriste interesin ndaj produktit të fermerëve vendës. Kjo skemë e aplikimit të TVSH-së është kundërshtuar me të gjitha format dhe nga të gjithë fermerët në masën 100 %. Nuk e kuptoj arsyen përse nuk rishikohet. Unë nuk them se skema aktuale është iniciuar për të dëmtuar fermerët, por pasi u provua, përse nuk ndryshon, ndërkohë që këtë e kërkojnë grupet e interesit? Më vjen ndërmend një thënie e mençur e Çerçillit, i cili thotë: "Nëse një njeri pi duhan pranë tabelës ku shkruhet 'Ndalohet duhani!', i duhet vënë gjobë, por, nëse aty pinë duhan 200 persona, atëherë duhet hequr tabela." Për këtë problem, si dhe për amendime të ligjit aktual për bujqësinë, unë së shpejti do të paraqes dy projektligje në lidhje me të cilat do të kërkoja një angazhim serioz nga ky parlament për të vlerësuar dhe për të gjykuar me korrektësi argumentet që do të paraqes. Këtë nuk e bëj thjesht për të bërë opozitë, po për të përmirësuar klimën e biznesit në sektorin e bujqësisë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale.

Gjithsesi, ju e keni në dorë. Mbetem me shpresë se këto që po themi nuk do të bien në vesh të shurdhër. Jam gati të bashkëpunoj për realizimin e këtyre dy projektligjeve. Nuk mund të rri pa thënë dy fjalë edhe për zhvillimin e sportit në vendin tonë. Në program, me aq sa lexova, u mundova të shihja me vëmendje edhe çështjet që kanë të bëjnë me sportin. Ka vetëm një paragraf, në të cilin flitet për

rritjen e klasave të profilizuara sportive, por nuk flitet për përmirësimin e ligjit aktual për sportin. Sot kemi disa donatorë, të cilët me tepër pasion japin para për disa lloje sportesh, por nuk përfitojnë pothuajse gjë nga ligji aktual. Për këtë shkak disa nga sportet e traditës në Shqipëri janë në kufijtë e mbijetesës. Megjithëse nuk mund të themi se nuk ka progres, për shkak të dialektikës ne sot nuk mund të konkurrojmë në volejball, basketboll, atletikë e të tjera me ekipet që konkurronin para '90-ës. Në atë kohë ato ekipe i konsideronin të dobëta, ndërsa sot nuk kalojmë dot një tur paraeliminator. Për fat këtu kam edhe një ish-koleg të volejbollit, zotin Pëllumbi dhe besoj se është dakord me këto që them unë. Brezit tim i kujtohet që në ato kohë ekipet e volejbollit, të basketbollit kalonin ekipet kampionë të Italisë, të Francës e të tjera, ndërsa sot nuk jemi në gjendje të kalojmë një tur paraeliminator. Kam pas shumë besim edhe për vetë të kaluarën e Kryeministrit që diçka do të bëhet për sportin, por, faktikisht, deri tani nuk është bërë asgjë. Nuk mund të mbetemi vetëm te zhvillimi i sportit në klasa sportive nëpër shkolla, por duhet patjetër të rregullohet ligji "Për sportin", përndryshe sporti nuk ka mbijetesë. Faleminderit!